



Raporti i Transparencës 2024

Deloitte Kosova SH.P.K.

Data e publikimit 30.04.2025



Përmbajtja

Deloitte Kosova mesazhi i lidërsipit	2
Rrjeti Deloitte	3
Deloitte Auditimi & Siguria: Angazhimi ynë për t'i shërbyer interesit publik	6
Monitorimi i jashtëm dhe i brendshëm i kualitetit	19
Pavarësia, etika, dhe shpalosje shesë	21
Shtojcat	25
Shtojca A Informacionet financiare	26
Shtojca B Entitetet me interes publik	27

Deloitte Kosova mesazh i idershipit¹

Ky raport përcakton praktikat dhe proceset që përdoren aktualisht nga Deloitte Kosova sh. p. k., në përputhje me kërkesat e nenit 4 të ligjit nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim të datës 30 Mars 2018, për kërkesat specifike në lidhje me auditimin ligjor të entiteteve me interes publik.

Ofrimi i shërbimeve të auditimit dhe sigurisë me cilësi të lartë, me integritet dhe parime të forta etike mbetet në brendësi të asaj që bëjmë ne. Ne krenohemi shumë me kulturën tonë të priorizimit të cilësisë dhe angazhimin tonë të palëkundur ndaj përsosmërisë profesionale. Gjersa kuadri rregullator evoluon, teknologjia përparon me shpejtësi dhe forcat makroekonomike formësojnë mjedisin e biznesit, rëndësia e rolit tonë në mbrojtjen e interesave publike të publikut investues vetëm se janë rritur. Në përgjigje të kësaj, ne vazhdojmë të investojmë në transformimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të biznesit tonë, duke rritur cilësinë, duke përmirësuar shërbimin ndaj klientit dhe duke kultivuar një mjedis pune ku njerëzit tanë mund të zgjerojnë aftësitë e tyre dhe të realizojnë potencialin e tyre.

Angazhimi ynë për përmirësim të vazhdueshëm përfshin njerëzit tanë, proceset dhe teknologjinë. Duke synuar transparencë më të madhe dhe duke vendosur standarde më të larta për veten tonë, ne synojmë jo vetëm të përmbushim, por edhe t'i tejkalojmë pritjet që publiku ka prej nesh.

Raporti i Transparencës 2024 i Deloitte Kosova paraqet një përmbledhje gjithëpërfshirëse të strukturës sonë organizative, mekanizmave të qeverisjes dhe mënyrës së ofrimit të shërbimeve të auditimit dhe sigurimit me standarde të larta cilësie, të mbështetura nga një sistem i qëndrueshëm i kontrollit të cilësisë. Ky raport publikohet çdo vit me synimin për të ndarë njohuri të rëndësishme mbi qasjen tonë ndaj qeverisjes korporative dhe transparencës.

Ne e vlerësojmë interesin tuaj për të mësuar më shumë se si po forcojmë kulturën tonë, duke qëndruar të përkushtuar ndaj etikës dhe integritetit dhe duke vazhduar të vendosim standardet e përsosmërisë në profesionin tonë.

Sinqerisht,

Arta Limani
Drejtoreshë



¹Përgjatë këtij raporti, termit "Deloitte, ne, dhe tona" i referohen një ose më shumë prej një ose më shumë Deloitte Touche Tohmatsu Limited, rrjetit të saj të firmave anëtare dhe subjekteve të lidhura me to. Për më shumë informacion rreth rrjetit Deloitte, ju lutemi shihni faqen 3 ose <https://www2.deloitte.com/global/en/pages/about-deloitte/articles/about-the-network.html>.

Rrjeti Deloitte

Deloitte Kosova: struktura ligjore dhe pronësia

Deloitte Kosova sh.p.k. është e lidhur me rrjetin Deloitte përmes Deloitte Central Europe Holdings Limited, një firmë anëtare e Deloitte Touch Tohmatsu Limited. Deloitte Central Europe Holdings Limited, së bashku me Deloitte France, Deloitte Germany, Deloitte Luxembourg, Deloitte Austria, Deloitte Portugal dhe Deloitte Turkey është një aksioner në Deloitte DCE GmbH ("DCE"), e cila është gjithashtu një firmë anëtare e Deloitte Touche Tohmatsu Limited. Qëllimi i DCE është nxitja e bashkëpunimit midis aksionerëve të saj si anëtarë të rrjetit global Deloitte. DCE as nuk ofron shërbime profesionale dhe as nuk angazhohet në aktivitete tregtare.

Deloitte Kosova sh.p.k. është referuar në të gjithë këtë raport si "Deloitte Kosova". Deloitte Central Europe, si një organizatë subjektsh të organizuara nën ombrellën e Deloitte Central Europe Holdings Limited, në të gjithë këtë raport referohet si "Deloitte Central Europe". Deloitte Central Europe Holdings Limited ka të drejta praktike për të ofruar shërbime profesionale duke përdorur emrin "Deloitte" të cilin e shtrin për entitetet e Deloitte brenda territorit të saj, duke përfshirë Deloitte Kosova. Deloitte Kosova është e autorizuar të shërbejë si auditor për klientet në Kosovë.

Deloitte Kosova operon si një kompani me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas ligjit të Kosovës, me zyre të regjistruar në Rr. Ukshin Hoti, nr.120, Komplexi Ramiz Sadiku, H C3/2a, kati i pestë në Prishtinë, 10000, Kosova, licensuar si firmë e huaj e auditimit, me numër të certifikatës 80452632 dhe numër të regjistrimit 810468373.

Struktura e pronësisë është si në vijim: DCE Holdings Ltd 49%, Arta Limani Beqiri 25.5% dhe Albana Shahu 25.5%.

Përshkrimi i rrjetit

Rrjeti Deloitte

Rrjeti Deloitte (i njohur gjithashtu si organizata Deloitte) është një rrjet i lidhur globalisht i firmave anëtare dhe subjekteve të tyre përkatëse të lidhura që operojnë në më shumë se 150 vende dhe territore në të gjithë botën. Këto firma anëtare të veçanta dhe të pavarura operojnë nën një markë të përbashkët.



Deloitte Touche Tohmatsu Limited (DTTL ose Deloitte Global)

Deloitte Touche Tohmatsu Limited është një kompani private e kufizuar me garanci të inkuorpuar në Angli dhe Uells. DTTL shërben një rol koordinues për firmat anëtare dhe entitetet e lidhura me to dhe vendos politika dhe protokolle me qëllim promovimin e një niveli të qëndrueshëm të cilësisë, sjelljes profesionale dhe shërbimit në të gjithë rrjetin e Deloitte. DTTL nuk ofron shërbime dhe nuk drejton, menaxhon, ose kontrollon asnjë firmë anëtare ose asnjë nga entitetet e lidhura me to.

"Deloitte" është marka nën të cilën rreth 460,000 profesionistë dhe praktikues të përkushtuar në firma të pavarura (ose entitetet përkatëse të lidhura) në të gjithë botën bashkëpunojnë për të ofruar auditim dhe siguri, konsulencë, këshillim financiar, këshillim për rrezikun, taksa dhe shërbime të ngjashme për klientët e përzgjedhur. Këto firma anëtare janë anëtarë të DTTL. DTTL, këto firma anëtare dhe secili prej entiteteve të tyre përkatëse të lidhura formojnë organizatën Deloitte. Çdo firmë anëtare e DTTL dhe/ose subjektet e lidhura me të ofrojnë shërbime në zona të veçanta gjeografike dhe i nënshtrohen ligjeve dhe rregulloreve profesionale të vendit ose vendeve në të cilat ato operojnë. Çdo firmë anëtare e DTTL është e strukturuar në përputhje me ligjet kombëtare, rregulloret, praktikën zakonore dhe faktorë të tjerë dhe mund të sigurojë ofrimin e shërbimeve profesionale në territoret e saj përkatëse nëpërmjet subjekteve të lidhura. Jo çdo firmë anëtare e DTTL ose subjektet e lidhura me të ofrojnë të gjitha shërbimet dhe disa shërbime mund të mos jenë të disponueshme klientet e auditimit dhe sigurisë sipas rregullave dhe rregulloreve të aplikueshme për firmat e auditimit. DTTL, dhe çdo firmë anëtare e DTTL dhe secili prej subjekteve të lidhura me të, janë ligjërisht të ndara dhe të pavarura, të cilat nuk mund të detyrojnë ose të lidhin njëra-tjetrën dhe janë përgjegjëse vetëm për veprimet dhe mosveprimet e tyre, dhe jo ato të njëra-tjetrës. Organizata Deloitte është një rrjet global firmash të pavarura dhe jo një partneritet apo një firmë e vetme. DTTL nuk ofron shërbime për klientët.

Deloitte Kosova: qeverisja – lidhshipi në veprim

Bordi i Drejtorëve të Deloitte Kosova është përgjegjës për qeverisjen dhe mbikëqyrjen e praktikës së Auditimit dhe Sigurisë. Përgjegjësitë specifike përfshijnë: miratimin e strategjisë së biznesit të auditimit dhe sigurisë, miratimin e pranimin të partnerëve dhe drejtuesit, miratimin e ndarjes së njësive dhe të fitimeve për partnerët dhe drejtuesit, si dhe miratimin e aspekteve financiare të planeve të biznesit.

Më poshtë janë anëtarët e Bordit të Drejtorëve të Deloitte Kosova të cilët janë emëruar nga Asambleja e Aksionarëve për afat të pacaktuar:

Deloitte Kosova – Bordi i Drejtorëve
Afrore Rudi, Partnere Menaxhuese
Olindo Shehu, Drejtor
Arta Limani Beqiri, Drejtoreshë
Albana Shahu, Drejtoreshë

Arta Limani është caktuar nga Deloitte Kosova si partnere udhëheqëse e praktikës së auditimit dhe sigurisë në Kosovë. Arta Limani dhe menaxhmenti i lartë i firmës zhvillon dhe zbaton strategjinë për praktikën e Auditimit dhe Sigurisë në Kosovë, duke përfshirë politikat dhe procedurat përkatëse. Në të gjitha aktivitetet e tyre, drejtuesit e lartë të Deloitte Kosova janë përgjegjës për objektivin kryesor të cilësisë së auditimit, duke përfshirë përputhjen me standardet e aplikueshme profesionale dhe kërkesat rregullatore. Strategjia Deloitte Kosova është zhvilluar në përputhje me drejtimin e përgjithshëm strategjik të vendosur për rrjetin Deloitte.

Liderët e Auditimit dhe Sigurisë të Deloitte Kosova marrin pjesë në grupet e rrjetit Deloitte që vendosin dhe monitorojnë standardet e cilësisë dhe nga të cilat burojnë një numër iniciativash për cilësinë e auditimit.

Qëllimi dhe angazhimi ynë: rrënjësja e besimit

Në Deloitte Kosova, qëllimi ynë është të bëjmë një ndikim që shkon përtej parashikimit. Për Auditimin dhe Sigurinë, kjo do të thotë një proces auditimi dhe sigurie në zhvillim të vazhdueshëm, duke shfrytëzuar teknologjinë më të avancuar, duke aplikuar një shumëllojshmëri aftësish, njohurish dhe përvoja për të ofruar shërbime me cilësi të lartë. Ne jemi shumë krenarë për rrënjësinë e besimit dhe besimit në tregjet e kapitalit dhe jemi të përkushtuar për të ngritur pa pushim standardet e cilësisë dhe duke vepruar gjithmonë me integritet, pavarësi dhe transparencë. Ne po ndërtojmë vazhdimisht aftësitë tona për të mbështetur ofrimin e projekteve të auditimit dhe sigurisë me cilësi të lartë dhe për të dhënë kontribute udhëheqëse në formësimin e së ardhmes së profesionit.



Deloitte Audit & Siguria: Angazhimi ynë për t'i shërbyer interesit publik

Një fokus në cilësi

Angazhimi i Deloitte për cilësi përshkon gjithçka që bëjmë. Auditimi i pavarur është një element qendror i ekosistemit të raportimit financiar, i vendosur për të mbrojtur investitorët dhe palët e tjera të interesuara, si dhe për të promovuar funksionimin efektiv të tregjeve të kapitalit.

Deloitte është shumë i vetëdijshëm për detyrimin tonë për të ofruar shërbime të auditimit dhe sigurisë që plotësojnë sfidat dhe kompleksitetet e mjedisit aktual, duke qenë në përputhje me standardet profesionale dhe rregullative. Që ekosistemi i raportimit financiar të funksionojë siç synohet, është jetike që roli i auditorit të ekzekutohet në mënyrë efektive.

Deloitte është e përkushtuar të bëjë më shumë sesa thjesht përmbushja e kërkesave rregullatore dhe konform pritshmërive. Deloitte synon të shkoj përtej pritshmërive për të vendosur standardin e përsosmërisë për profesionin. Në përputhje me këtë objektiv, angazhimi ynë për cilësinë e auditimit është i padiskutueshëm.

Lidershipi Global i Deloitte

Ekzekutivi Global i Auditimit dhe Sigurimit të Deloitte, i cili përfshin

Liderët e Biznesit të Auditimit dhe Sigurimit nga firmat më të mëdha anëtare, udhëhiqet nga Jean-Marc Mickeler, Lideri i Biznesit të Auditimit dhe Sigurimit Global të Deloitte. Përgjegjësitë e tij përfshijnë punën me firmat anëtare për të përcaktuar dhe drejtuar strategjinë globale të auditimit dhe sigurimit, me një fokus të veçantë në:

- Drejtimin e iniciativave kyçe të auditimit dhe sigurimit nëpërmjet rrjetit të Deloitte për të arritur rezultate cilësore.
- Udhëheqjen e iniciativave transformuese për të inovuar mënyren se si realizohen projektet tona të auditimit dhe sigurimit për të përmbushur nevojat në rritje të palëve të interesuara.

Kompania që mbajmë

Si pjesë e angazhimit të Deloitte Audit & Assurance për të mbështetur tregjet e kapitalit, ne jemi të fokusuar në subjektet audituese ku i shërben interesit publik dhe ku kemi aftësitë për të kryer një auditim cilësor me objektivitet dhe në përputhje me standardet profesionale dhe ligjet dhe

rregulloret në fuqi, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me etikën dhe pavarësinë.

Kompania që mbajmë është një aspekt i rëndësishëm i strategjisë sonë të Auditimit dhe Sigurisë dhe vlerave të përbashkëta globale që udhëheqin sjelljen tonë për të udhëhequr rrugën, për të shërbyer me integritet, për t'u kujdesur për njëri-tjetrin, për të nxitur përfshirjen dhe për të bashkëpunuar për ndikim të dukshëm. Deklarata e gatishmërisë për rrezikun në portofolin tonë të auditimit dhe sigurimit shërben si bazë për kompaninë të cilën mbajmë. Deklarata e gatishmërisë për rrezikun mund të përdoret si një mjet për të promovuar një diskutim të fortë të rrezikut dhe si një bazë mbi të cilën vendimet e pranimi dhe të vazhdimësisë mund të debatohen dhe sfidohen në mënyrë efektive dhe të besueshme. Deklarata, siç tregohet më poshtë, përcakton tonin për kulturën e rrezikut dhe synon të nxisë konsistencën në procesin e pranimi të angazhimit dhe vazhdimësisë së vendimmarrjes:

Gatishmëria për rrezik në portofolin e Auditimit dhe Sigurimit të Deloitte përbën themelin e axhendës sonë të udhëhequr nga qëllimi dhe forcon Parimet tona të Sjelljes në Biznes, të cilat shprehin standardet ndaj të cilave angazhohemi, kudo që jetojmë dhe punojmë në botë, me qëllim ndërtimin dhe ruajtjen e një biznesi të qëndrueshëm për gjeneratat e tanishme dhe ato të ardhshme.

Në përputhje me angazhimin tonë ndaj qëllimit dhe veprimit në interes publik, ne e pranojmë se marrja e një niveli të caktuar rreziku është një pasojë e natyrshme e ushtrimit të aktivitetit biznesor. Për të ofruar shërbime cilësore të auditimit dhe sigurimit, ne identifikojmë dhe menaxhojmë në mënyrë proaktive rrezikun përmes proceseve, politikave dhe procedurave tona të menaxhimit të cilësisë, me qëllim marrjen e vendimeve të informuara që janë në përputhje me strategjinë dhe vlerat tona.

Ne aspirojmë të kemi një portofol klientësh që përputhet me vlerat tona të përbashkëta, respekton profesionistët tanë, njeh çështjet në zhvillim dhe përgjegjësitë shoqërore dhe angazhohet për të ofruar transparencë për palët e interesuara në ekosistemin e raportimit financiar. Ne përpiqemi të kemi një portofol që nuk përfshin klientë të cilëve u mungon integriteti, përfshihen në aktivitete të paligjshme, shpërfillin vërtetësinë e kontabilitetit financiar dhe raportimit, ose nuk janë të gatshëm të vendosin dhe mbajnë kontrolle të brendshme të mjaftueshme dhe procese përkatëse.

Deloitte Kosova ka politika dhe procedura të detajuara për pranimin e klientëve të mundshëm, vazhdimin e angazhimeve ekzistuese dhe vlerësimin e rrezikut të angazhimit. Këto politika dhe procedura janë hartuar me objektivin që Deloitte Kosova të pranojë ose të vazhdojë me angazhime vetëm kur:

- Është në gjendje të kryejë angazhimin dhe ka aftësitë, duke përfshirë kohën dhe burimet, për ta bërë këtë.
- Mund të pajtohet me të gjitha standardet përkatëse profesionale dhe ligjet dhe rregulloret, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me etikën dhe pavarësinë dhe vlerësimet dhe konsideratat e konfliktit të interesit.
- Konsideron që ekipi menaxhues i klientit të veprojë me integritet dhe në përputhje me vlerat tona të përbashkëta.

Më pak, por firma të forta anëtare

Në kuadër të strukturës së firmave anëtare të Deloitte, Deloitte Kosova është pjesë e firmës anëtare Deloitte Central Europe Holdings Limited. Si firmë auditimi e regjistruar dhe e rregulluar në nivel lokal në Kosovë, ne kemi autoritet vendimmarrës në lidhje me çështjet rregullatore dhe obligimet profesionale dhe mbajmë përgjegjësinë përfundimtare për ekzekutimin e shërbimeve të auditimit dhe sigurisë në përputhje me standardet profesionale dhe ligjet dhe rregulloret vendore. Deloitte Kosova është përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe funksionimin e një sistemi efektiv të menaxhimit të cilësisë për të mbështetur performancën e angazhimeve të auditimit dhe sigurimit të cilësisë së lartë. Si anëtar të një firme të kombinuar brenda rrjetit Deloitte, ne punojmë në bashkëpunim të ngushtë me vendet e tjera gjeografike në firmën anëtare të Deloitte Central Europe Holdings Limited dhe përfitojmë nga mbikëqyrja shtesë e cilësisë, menaxhimit të rrezikut dhe aktiviteteve të monitorimit. Kjo

strukturë nxit investimet e përbashkëta në inovacionin dhe burimet e auditimit, si dhe ndarjen e praktikave udhëheqëse nëpër vendet gjeografike, duke nxitur standardizimin dhe qëndrueshmërinë në veprimtarinë e auditimit dhe sigurimit, dhe duke kontribuar në aspiratat tona të përbashkëta për përmirësim të vazhdueshëm në cilësi.



Angazhimi i njerëzve tanë për integritet, për t'i shërbyer interesit publik dhe për të ofruar siguri të cilësisë së lartë në fushat që kanë më shumë rëndësi për palët tona të interesit është në thelb të gjithçkaje që bëjmë.

Përkushtimi ynë i palëkundur ndaj cilësisë drejton pozicionin tonë të qëndrueshëm drejtues të cilësisë Ne mbetemi të fokusuar në përsosmërinë mes njerëzve, procesit dhe teknologjisë. Secili prej këtyre komponentëve thelbësorë na ndihmon të ofrojmë vizionin tonë për një të ardhme më të mirë, duke krijuar një ndikim që por shkon përtej pritshmërive.

Si duket kjo? Një praktikë auditimi dhe sigurie në zhvillim të vazhdueshëm, duke shfrytëzuar mendjet e ndritura, proceset efektive dhe teknologjitë e klasit botëror nga e gjithë organizata jonë, duke u mbështetur në përvojën tonë shumëvjeçare. Ne ofrojmë shërbime me cilësi të lartë në një mënyrë efikase dhe efektive që ruan integritetin, ndërton besimin dhe nxit vlerën duke u fokusuar në atë që ka vërtet rëndësi.

Strategjia e transformimit dhe ndryshimit të Auditimit dhe Sigurimit është e fokusuar në rezultatet e mëposhtme:

Transformimi dhe mundësi i ekzekutimit të Auditimit dhe Sigurimit me teknologji për të shfrytëzuar fuqinë e inovacionit	Zhvillimi i vazhdueshëm i produkteve të Auditimit dhe Sigurimit të Deloitte për t'u përgjigjur nevojave të ardhshme të palëve të interesuara
Transformimi i përvojës së talenteve, duke përfshirë përdorimin e modeleve të avancuara të ofrimit të shërbimeve	Mbështetja e njerëzve tanë gjatë transformimit dhe ndryshimeve në mënyrë të qëndrueshme në të gjithë botën

Ofrimi i përsosmërisë së auditimit përmes procesit, njerëzve dhe transformimit të teknologjisë²

Me Deloitte Way, Deloitte po sjell inovacion në thelbin e mënyrës se si ekzekutohen angazhimet tona: me automatizim që përmirëson detyrat rutinore dhe analitikë që mbështet ekzekutimin e auditimit – duke dhënë një pamje më të thellë dhe më të detajuar në të dhënat e disponueshme. Si rezultat, ne po përmirësojmë cilësinë e shërbimeve që kryejmë duke krijuar gjithashtu një përvojë më të pasur talentesh për njerëzit dhe klientët tanë.

Inovacioni dhe mundësi i teknologjisë janë një pritshmëri në botën e sotme të biznesit që ndryshon me shpejtësi, dhe kjo pritshmëri vlen edhe për profesionin tonë gjithashtu. Mjedisi kompleks i sotëm i biznesit kërkon që auditimi të jetë dinamik, shumëdimensional dhe i thellë. Ekziston një kërkesë për informacione relevante në kohë reale dhe ne duhet të zhvillojmë shërbimet tona te auditimit dhe sigurisë pasi që klientët e Deloitte inovojnë bizneset dhe proceset e tyre. Duke shfrytëzuar teknologjinë dhe të dhënat në zhvillim, Deloitte ofron njohuri më të thella për të krijuar auditim dhe siguri më të qëndrueshme, transparente dhe të vlefshme për palët tona të interesuara.

Deloitte është e përkushtuar ndaj investimeve të vazhdueshme në teknologjitë në zhvillim dhe larminë e mendimit që mundëson ofrimin e cilësisë, njohurive dhe vlerës së përmirësuar për klientët tanë dhe tregjet. Platformat e auditimit global të Deloitte, Deloitte Omnia dhe Deloitte Levvia, demonstrojnë përkushtimin tonë për të ofruar projekte dixhitale të cilësisë së lartë të të gjitha madhësive dhe niveleve të kompleksitetit. Deloitte Omnia është platforma jonë bazuar në “cloud” kompjuterike, e plotë dhe e integruar për angazhime të mëdha dhe komplekse, ndërsa Deloitte Levvia ofron një eksperiencë dixhitale të thjeshtuar dhe të përshtatëshme për entitete me rrezik më të ulët dhe më pak komplekse. Përmirësimi i vazhdueshëm dhe shpërndarja globale e të dyja platformave janë në proces dhe do të vazhdojnë ndërkohë që do të integrojmë më tej inovacion për një përvojë të dalluar për klientët dhe auditorët.

Strategjia GenAI e Auditimit dhe Sigurimit të Deloitte

Deloitte A&S vazhdon të investojë në inovacionin e inteligjencës artificiale, dhe ne tashmë kemi bërë përparime të mëdha në transformimin e ofrimit të punës sonë me teknologjitë tona inovative, si Deloitte Omnia dhe Deloitte Levvia. Ne jemi të fokusuar në përdorimin etik dhe të përgjegjshëm të GenAI për klientët tanë dhe njerëzit tanë:

²Për më shumë informacion rreth inovacionit të auditimit të Deloitte, ju lutemi referojuni faqeve si [Raportit të Ndikimit Global të Deloitte](#), [dhe Zhvillimi i Auditimit](#) dhe [Auditimi dhe Siguria: Rruga e Deloitte](#)

- Brenda entiteteve që ne auditojmë, ne po vlerësojmë ndikimin e implementimit të inteligjencës artificiale në raportimin financiar dhe shpalosjet e tjera, si dhe vlerësimin dhe reagimin e entitetit ndaj rreziqeve të lidhura me inteligjencën artificiale (përfshirë kontrollin e brendshëm përkatës). Ne presim që kompanitë të fillojnë të adoptojnë dhe të përfshijnë inteligjencën artificiale në proceset e tyre të biznesit, dhe ne do të jemi të gatshëm të shqyrtojmë çdo pasojë të rëndësishme për proceset e raportimit financiar.
- Ne jemi duke e vlerësuar se si mund të përdorim Gen AI në auditimet tona dhe vazhdojmë të përqendrohemi në shfrytëzimin e fuqisë së teknologjive kognitive brenda platformave tona Deloitte Omnia dhe Deloitte Levvia. Aktualisht kemi disa zgjidhje që përdorin IA. Në të ardhmen, besojmë se GenAI do të mbështesë më tej auditorët tanë në ofrimin e auditimeve të cilësisë së lartë, përfshirë mbështetjen për ndjeshmërinë ndaj rrezikut, identifikimin e çështjeve të mundshme dhe automatizimin e disa proceseve. Skepticizmi profesional dhe aftësitë që mbështetemi tek to si auditorë do të mbeten thelbësore për përdorimin e përgjegjshëm dhe vlerësimin e IA, veçanërisht të GenAI.
- Së fundi, po investojmë shumë në mësimin dhe zhvillimin për profesionistët dhe praktikuesit e Auditimit dhe Sigurimit të Deloitte, duke i trajnuar ata mbi ndikimin e Gen AI, rreziqet, kufizimet dhe pritshmëritë për mënyrën se si të përdorin Gen AI në mënyrë efektive në angazhimet e tyre.

Raportimi mbi qëndrueshmërinë³

Themelet e biznesit po ndryshojnë me shpejtësi, elasticiteti afatgjatë dhe aftësia për të krijuar vlera të qëndrueshme është e lidhur drejtpërdrejt me përafrimin me vlerat dhe pritshmëritë e shoqërisë. Pjesëmarrësit e tregut dhe palët më të gjera të interesit po bëjnë thirrje për një pasqyrë më të madhe se si organizatat do të ndërtojnë, mbrojnë dhe përmirësojnë vlerën e ndërmarrjes me kalimin e kohës, dhe posaçërisht kërkojnë transparencë të shtuar rreth ndikimeve në lidhje me klimën dhe aspekteve më të gjera mjedisore, sociale dhe të qeverisjes (ESG) dhe varësive të modelit dhe strategjisë së biznesit të një kompanie.

Veçanërisht, Deloitte pranon se ngrohja globale përbën një rrezik për stabilitetin financiar dhe ndikon në shumë sektorë të bizneseve me rritjen shpalosjeve dhe pritshmërive të raportimit nga palët e tjera të interesit. Qasja e auditimit të Deloitte është e dizajnuar për të promovuar një vlerësim të qëndrueshëm dhe të

përshtatshëm të rreziqeve dhe mundësive të lidhura me klimën, që mundëson një kuptim më të thellë të ndikimeve të mundshme të ndryshimeve klimatike në pasqyrat financiare, duke mundësuar vlerësimin dhe perfundimet e dokumentuara mirë. Ne vazhdojmë të theksojmë këtë me njerëzit tanë përmes mësimave, udhëzimeve dhe burimeve të tjera.

Evolucioni nga raportimi financiar tradicional në raportimin më të gjerë të korporatave po ndodh me ritëm të shpejtë, me një aktivitet të rëndësishëm në përcaktimin e standardeve që i shtyn kompanitë të përgatiten për kërkesa të reja ose të përmirësuara të shpalosjeve. Standardet e Zbulimit të Qëndrueshmërisë të IFRS-së të publikuara nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Qëndrueshmërisë (BNSQ) krijojnë një bazë globale për raportimin e qëndrueshmërisë. Vendet e tjera kanë miratuar kërkesat e tyre për raportim të korporatave, veçanërisht Direktivën e BE-së për Raportimin e Qëndrueshmërisë së Korporatave (CSRD), e cila kërkon raportim në përputhje me Standardet Evropiane të Raportimit të Qëndrueshmërisë (ESRS) dhe ka shtrirje të konsiderueshme jashtëterritoriale, si dhe rregullin e SEC-it të SHBA-së për shpalosjen e klimës, i cili kërkon që regjistruarit të shpalosin rreziqet që lidhen me klimën. Deloitte është një mbështetës i fuqishëm i raportimit të përmirësuar për qëndrueshmërinë dhe e njeh rolin e rëndësishëm që luan në rritjen e ndërgjegjësisë për këto kërkesa të reja përmes angazhimit aktiv me palët e interesuara.

Standardet e raportimit korporativ dhe kërkesat rregullatore synojnë të nxisin një lidhje më të mirë midis raportimit financiar dhe jofinanciar, si dhe t'u ndihmojnë përdoruesve të shpalosjeve korporative të kuptojnë dhe krahasojnë më mirë informacionin mbi entitetet. Për të qenë efektive, këto standarde duhet të mundësojnë raportim korporativ që është i krahasueshëm, i bazuar në një standard themelor global dhe i plotësuar me konsiderata lokale aty ku është e nevojshme. Duke marrë parasysh natyrën gjithëpërfshirëse të disa kërkesave për raportim të qëndrueshmërisë dhe ritmin me të cilin ato janë zhvilluar, në treg është e nevojshme udhëzues dhe interpretim shtesë për të mbështetur si përgatitësit, ashtu edhe përdoruesit e këtij informacioni. Ndërsa këto standarde integrohen në rregulloret në mbarë botën, bashkë me to po zbatohen edhe mekanizmat për zbatueshmëri, monitorim, qeverisje dhe kontrolle, sigurim cilësie, si dhe trajnime. Është thelbësore që i gjithë ekosistemi i raportimit për qëndrueshmëri—përfshirë hartuesit e standardeve, politikëbërësit dhe rregullatorët—të punojnë së bashku për të kufizuar

³Për më shumë informacion në lidhje me përafrimin e Deloitte me ESG, ju lutemi referojuni Deloitte [Global Impact Report](#).

fragmentimin dhe për të mbështetur një raportim të qëndrueshëm, të krahasueshëm dhe të harmonizuar.

Deloitte kupton se duke pasur parasysh rreziqet e shtuara që lidhen me ndryshimet klimatike, është e rëndësishme që faktorët e lidhur me klimën të përfshihen siç duhet në raportimin e korporatës. Sot, disa pritshmëri të palëve të interesuara mund të mos përmbushen nga pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me kornizat aktuale të kontabilitetit. Gjersa raportimi i korporatave vazhdon të evoluojë dhe palët e interesuara përshtaten me ndryshimet e tregut dhe ndjenjën publike, është e rëndësishme të lejohet një proces i duhur në mënyrë që të zhvillohen standarde të qëndrueshme të aplikuara në mënyrë konsistente në të gjithë globin dhe për të nxitur raportimin që i përgjigjet kërkesave në rritje të investitorët dhe palët e tjera të interesuara.

Deloitte mbetet e përkushtuar për t'u angazhuar në biseda kuptimplote dhe transparente me investitorët, vendosësit e standardeve, rregullatorët dhe palët e tjera të interesuara. Ne vazhdojmë të mbështesim zvogëlimin e fragmentimit të standardeve dhe rregulloreve, dhe presim me optimizëm një besim më të madh në treg me arritjen e përputhshmërisë globale të standardeve.

Siguria

Me rritjen e fokusit dhe shqyrtimit të raportimit të ESG-së vjen gjithashtu nevoja e shtuar për besim mbi cilësinë e informacionit që shpaloset ne from të sigurisë së pavarur. Sigurimi mbi raportimin e qëndrueshmërisë po bëhet gjithnjë e më shumë i detyrueshëm, siç dëshmohet nga rregulloret për raportimin korporativ të miratuara në Bashkimin Evropian, të cilat kërkojnë sigurim të kufizuar me pritshmërinë që në vitet në vijim të kalojë në sigurim të arsyeshëm.

Kërkesa në rritje për sigurim të qëndrueshmërisë thekson rëndësinë e standardeve profesionale që mundësojnë zbatim të qëndrueshëm dhe me cilësi të lartë në nivel global. Deloitte e mbështet punën e IAASB për zhvillimin e një standardi global për sigurimin e qëndrueshmërisë, ISSA 5000, si një bazë globale për këtë qëllim. Përdorimi i gjerë i ISSA 5000 është thelbësor për të shmangur kompleksitetin dhe kostot e panevojshme që vijnë nga standardet e fragmentuara të sigurimit.

Deloitte është mirë e pozicionuar për të ofruar sigurim të cilësisë së lartë mbi informacionin ESG. Si auditorë, ne mbajmë parimet themelore të integritetit, besueshmërisë dhe objektivitetit dhe respektojmë kërkesat profesionale lidhur me kompetencën, pavarësinë dhe sistemet e menaxhimit të cilësisë. Puna jonë e auditimit dhe sistemet përkatëse janë të subjektuara nën mbikëqyrje dhe inspektim, si dhe mekanizmave të përgjegjësisë

profesionale për të siguruar që sigurimi i besueshëm t'i ofrohet tregut.

Më poshtë janë veprimet specifike që Deloitte po ndërmerr për të mbështetur ekzekutimin e sigurisë me cilësi të lartë, që adresojnë siç duhet raportimin vullnetar të ESG-së si dhe kërkesat rregullatore të detyrueshme:

- Zhvillimi dhe përmirësimi i udhëzimeve për kryerjen e sigurimit ESG përmes metodologjisë globale të sigurimit të qëndrueshmërisë të Deloitte, e cila përfshin udhëzime shtesë për standardet dhe kornizat specifike të raportimit të qëndrueshmërisë. Në veçanti, ne kemi plotësuar metodologjinë tonë globale të sigurimit ESG me udhëzime, mjete dhe shabllone të veçanta për kryerjen e sigurimit të kufizuar mbi raportimin e qëndrueshmërisë sipas CSRD.
- Ndërtimi i kapacitetit përmes mësimit global dhe të lokalizuar, i fokusuar në ESG.
- Zhvillimi dhe fillimi i implementimit të zgjidhjeve të mundësuar nga teknologjia, si një mjet për të vlerësuar shpalosjet e qëndrueshmërisë së një kompanie në krahasim me standardet e zakonshme ESG
- Angazhimi në formësimin e infrastrukturës së tregut të kapitalit për raportimin e qëndrueshmërisë, i lidhur me vlerën e ndërmarrjes përmes bashkëpunimit për raportimin e përcaktimit të standardeve të klimës dhe ESG, dhe iniciativave të sigurimit, si Fondacioni SNRF, Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Auditimit dhe Sigurisë dhe Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Etikës për Kontabilitet.
- Pjesëmarrja aktive në platforma të ndryshme globale si Forumi Ekonomik Botëror dhe Konventa në Kuadër të OKB-së e vitit 2023 për Ndryshimet Klimatike (COP28).

Deloitte mbështet bashkëpunimin e vazhdueshëm të të gjithë pjesëmarrësve në ekosistemin e raportimit financiar, duke punuar së bashku për të zhvilluar dhe zbatuar standarde të përbashkëta mbi të cilat mund të matet, shpaloset dhe në fund të sigurohet informacioni ESG.

Angazhimi i Deloitte

Më tej, për të ndihmuar botën të arrijë qëllimet e Marrëveshjes së Parisit⁴, Deloitte është e përkushtuar [WorldClimate](#), një strategji për të drejtuar zgjedhje të përgjegjshme klimatike brenda rrjetit të Deloitte dhe më gjerë.

Referojuni publikimit të ardhshëm të Raportit Global të Ndikimit 2024 të Deloitte për raportin e plotë mbi këtë iniciativë të rëndësishme.

Modeli multidisiplinar (MDM)

MDM i Deloitte sjell gjerësinë dhe thellësinë e shërbimeve në të gjithë bizneset e Deloitte, duke lidhur shumë disiplina të ndryshme për të ofruar ekspertizë dhe një perspektivë të gjerë. MDM është një forcë thelbësore e Deloitte dhe do të mbetet baza e strategjisë sonë. Strategjia dhe modeli ynë aktual i biznesit kanë një ndikim pozitiv në cilësi

Në veçanti, fusha e raportimit korporativ është në zgjerim dhe transformim të konsiderueshëm çdo ditë, me kërkesat e reja për shpalosjet vullnetare dhe të detyrueshme në lidhje me ESG, cyber, IA, privatësinë e të dhënave dhe shumë më tepër. Deloitte krenohen me një ekip të thellë specialistësh të pavarur, të cilët mund të angazhohen në mbarë botën në angazhimet e auditimit dhe sigurimit për të ofruar ekspertizë të fushës dhe perspektiva të reja dhe të thella.

Ndër përfitimet e MDM janë:

- Mundësia për të zhvilluar njohuri të industrisë ose tematike (p.sh., klima, qeverisja, strategjia e korporatës, etj.) përmes këndvështrimeve të shumta, gjë që rrit të kuptuarit e auditorëve për rreziqet e biznesit që lidhen me kryerjen e shërbimeve të auditimit dhe sigurisë.
- Gjerësia e MDM krijon mundësi më të pasura të karrierës dhe mobilitetit për njerëzit tanë, duke e bërë biznesin tërheqës për kandidatët që mund të dëshirojnë mos t'i kufizojnë opsionet e tyre të karrierës vetëm në ofrimin e shërbimeve të auditimit dhe sigurisë
- Shkalla e MDM sjell më shumë qëndrueshmëri për secilën linjë biznesi të Deloitte, përfshirë auditimin dhe sigurimin, duke mundësuar vazhdimin e investimeve në teknologji, metodologji dhe procese për të mbështetur ofrimin e shërbimeve të cilësisë së lartë, ndërkufitare

Deloitte pranon se çdo linjë biznesi e Deloitte është e rëndësishme dhe kritike për aftësinë e organizatës për të përbushur përgjegjësitë e saj për interesin publik. Vëmendja e menaxhmentit dhe shpërndarja e investimeve nuk janë të kufizuara në linjat e biznesit me normat më të larta të rritjes.

Deloitte pranon, megjithatë, mundësinë dhe perceptimin e konfliktit të interesit, dhe për këtë arsye ka politika dhe sisteme të fuqishme pavarësie për të ndihmuar në sigurimin që strategjia e Deloitte të zbatohet në përputhje me kërkesat rregullatore dhe profesionale. Në disa fusha, politikat e Deloitte janë më të rrepta sesa ato që kërkojnë standardet profesionale ose ligjet ose rregulloret.

Megjithëse ne gjithmonë vlerësojmë mënyra për të përmirësuar aftësinë e Deloitte për të realizuar mandatet tona në interes të publikut, ne mbetemi të sigurt se MDM i Deloitte dhe qëllimi dhe vlerat tona të përbashkëta na bëjnë mirë të pozicionuar për të kaluar përmes sfidave të ardhshme, duke vazhduar të udhëheqim me cilësi.

⁴ [Marrëveshja e Parisit](#) është një traktat ndërkombëtar ligjërshat i detyrueshëm për ndryshimet klimatike. Ai u miratua nga 196 palë në Konferencën e Kombeve të Bashkuara (OKB) për Ndryshimet Klimatike (COP21) në Paris, Francë, më 12 dhjetor 2015 dhe hyri në fuqi më 4

nëntor 2016. Sipas OKB-së, qëllimi i saj kryesor është të mbajë rritjen e temperaturës mesatare globale nën 2°C mbi nivelet para-industriale dhe të ndjekë përpjekjet për të kufizuar rritjen e temperaturës në 1.5°C mbi nivelet para-industriale.

Formësimi i së ardhmes së profesionit

Ofrimi i informacionit të rëndësishëm dhe të besueshëm financiar dhe, gjithnjë e më shumë, jo-financiar është thelbësor si për tregjet e kapitalit ashtu edhe për shoqërinë në përgjithësi. Politikëbërësit, rregullatorët, investitorët, drejtuesit e kompanive, komitetet e auditimit dhe auditorët kanë të gjithë një rol të rëndësishëm në mënyrë që përdoruesit e informacionit korporativ të kenë një pamje të qartë dhe të fortë të pasigurive dhe rreziqeve në modelin e biznesit të një kompanie, për të mbështetur vendimmarrjen e tyre të informuar.

Pasiguria dhe kompleksiteti pritet të mbeten një temë qendrore në vitet në vijim, të shtyra nga sfida të shtuara globale dhe përparimi i shpejtë i teknologjisë.

Në mjedisin e sotëm, një ndërgjegjësim i shtuar rreth rrezikut të lartë të mashtrimit, pranisë së faktorëve të rrezikut të rinj apo në zhvillim, dhe nevojës për mjedise efektive të kontrollit të brendshëm mbetet thelbësor. Megjithëse kuadrot ekzistuese të kontabilitetit parashikojnë pasiguritë, përdoruesit e pasqyrave financiare dhe rregullatorët duhet të presin një shkallë të lartë të paqëndrueshmërisë së tregut dhe ekonomisë në afat të shkurtër.

Deloitte ka mirëpritur vazhdimisht deklaratat publike dhe udhëzimet e publikuara nga rregullatorët, që njohin pasiguritë dhe theksojnë rëndësinë e raportimeve korporative cilësore dhe me qasje të orientuar drejt së ardhmes. Transparenca më e madhe i shërben interesit publik, ashtu siç ndihmon edhe rritja e ndërgjegjësimit për këto çështje, veçanërisht kur të gjithë pjesëmarrësit në ekosistemin e raportimit korporativ marrin pjesë. Më shumë qartësi rreth përgjegjësiave unike dhe plotësuese të menaxhmentit, komiteve të auditimit, entiteteve, auditorëve, rregullatorëve dhe palëve të tjera të interesuara u mundëson investitorëve të mbajnë përgjegjësi këta aktorë në një mënyrë efektive që i shërben interesit publik.

Rëndësia e shërbimeve të auditimit dhe sigurimit me cilësi të lartë nuk zbehet në mes të trazirave globale. Përkundrazi, investitorët dhe palët e tjera të interesuara vazhdojnë të kërkojnë shërbime profesionale të bazuara në parime dhe praktika të pavarësisë dhe objektivitetit, për të nxitur besimin dhe për të krijuar siguri në tregjet e kapitalit — dhe Deloitte është e përkushtuar të udhëheqë këtë rrugë.

Përkushtimi i Deloitte Kosova për t'i shërbyer interesit publik—veçanërisht në lidhje me sjelljen sipas standardeve më të larta të etikës, integritetit, pavarësisë dhe transparencës—mbetet i palëkundur. Deloitte është plotësisht i vetëdijshëm për peshën e përgjegjësisë që shoqëron përmbyshjen e detyrimeve profesionale dhe

ushtrimin e rolit të saj si auditor në ekosistemin global të raportimit korporativ. Parimet e mëposhtme mbeten në qendër të vëmendjes dhe përforcohen vazhdimisht tek profesionistët e Auditimit dhe Sigurimit:

- Ushtrimi i skepticizmit profesional dhe kujdesit të duhur profesional.
- Vlerësimi kritik i cilësisë së dëshmive të sigurara të auditimit dhe përcaktimi nëse ato janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të adresuar rreziqet përkatëse
- Marrja e gjykimeve profesionale të arsyetuara dhe të mbështetura nga dokumentacion i qartë.
- Nxjtja e një kulture të përsosmërisë dhe konsultimit
- Demonstrimi i përkushtimit ndaj integritetit dhe sjelljes etike, përfshirë edhe respektimin e detyrimeve rregullatore dhe profesionale
- Mbajtja e lidhjeve të forta dhe mbështetja e njëri-tjetrit

Ne po zhvillohemi vazhdimisht për të përmirësuar efektivitetin tonë përmes teknologjisë, të dhënave dhe mënyrave të punës. Në mënyrë paralele, roli i auditimit dhe sigurimit në ekosistemin e raportimit korporativ, përgjegjësia e tij për të vepruar në interes të publikut, dhe kontributi i tij në zhvillimin e vlerës shoqërore mbeten në krye të punës sonë në këtë fushë. Përmes angazhimit proaktiv me një gamë aktorësh, ne synojmë të kuptojmë çështjet që shoqëria po përballë sot dhe që po zhvillohen me shpejtësi (p.sh., ESG, kibernetikë, AI, privatësia e të dhënave, etj.) dhe rolin që auditimi dhe siguri mund të luajnë në përgjigjen dhe nxjerrjen e ndryshimeve pozitive për të mirën e përgjithshme.

Ne synojmë të angazhohemi me këto palë, si formalisht ashtu dhe informalisht, për të ndarë, ofruar dhe debatuar ide që nxisin ambicien tonë të përbashkët për të siguruar rëndësinë e vazhdueshme dhe në rritje të auditimit dhe sigurimit për tregjet e kapitalit.



Zhvillimi profesional dhe menaxhimi i performancës

Kultura e përsosmërisë së Deloitte dhe hartimi i programeve të të mësuarit i vendos njerëzit në ballë⁵. Praktikuesit e Deloitte janë teknikisht të aftë me nivele të larta të etikës, integritetit, skepticizmit profesional dhe objektivitetit, duke zbatuar gjykimin dhe përvojën e tyre me pasion dhe përkushtim. Ne po përmirësojmë vazhdimisht aftësitë, njohuritë dhe përvojën tonë për të shkuar përtej pritshmërive dhe për të dhënë ndikim domethënës.

Deloitte është e përkushtuar për të ofruar një përvojë të pakrahasueshme talentesh, duke zhvilluar praktikues dhe për të çuar më tej karrierën e tyre duke krijuar një mjedis të të mësuarit gjatë gjithë jetës - duke avancuar edukimin, aftësitë dhe opsionet fleksibël të karrierës që tërheqin auditorët e sotëm dhe të nesërm.

Praktikuesit e Deloitte sjellin prejardhje, njohuri dhe aftësi të ndryshme që rrisin aftësitë si organizatë në ofrimin e cilësisë më të lartë. Ne mbështesim dhe fuqizojmë njerëzit tanë që të arrijnë potencialin e tyre të plotë duke vlerësuar dhe demonstruar diversitetin, barazinë, përfshirjen dhe mirëqenien.

Deloitte njeh dhe shpërblen praktikuesit dhe profesionistët e auditimit dhe sigurisë dhe bën investime të vazhdueshme në të ardhmen e tyre.



